



PROGRAMI POLITIKE I PEK  
(PARTIA EUROATLANTIKE E KOSOVES)

## EKONOMIA

Partia Euroatlantike e Kosovës (PEK) do të angazhohet për një ekonomi të tregut

1. PEK do të jetë e përkushtuar për një rritje të qëndrueshme dhe të shpejtë ekonomike

PEK-u rritjen ekonomike do ta mbështes në këto synime:

- Ruajtjen e ritmeve të verifikuara të rritjes së sektorëve kryesor të zhvillimit ekonomik;
- Vazhdimësinë e stabilitetit politik, institucional dhe makroekonomik;
- Impaktin pozitiv në thellimin e reformave institucionale dhe strukturore;
- Kombinim të shfrytëzimit të faktoreve ekstensiv me aktivizim të atyre intensiv të rritjes;
- Investim në rritjen e kapaciteteve të kapitalit njerëzor;
- Përthithjen e kapitalit njerëzor të edukuar jashtë Kosovës.
- Nivel të lartë në akumulimin monetar dhe transfertave private;
- Impakte të pritura pozitive të hapjes ekonomike, integrim rajonal dhe hapa konkretë drejt integritimit në BE.
- Nxitje të investimeve, sidomos të Investimeve të huaja direkte me fokus të veçantë investimet nga diaspora shqiptare.

## 2. PËRMIRËSIMI I SHTETIT LIGJOR

PEK do të garantoj sigurinë, pronën dhe pasurinë e qytetarëve duke e avancuar sundimin e ligjit, si dhe efikasitetin e shërbimit civil.

- **Legjislacioni:** duke përfunduar dhe përshtatur kornizën legjislative, rrethanave vendore dhe koordinimin me ekspert vendor dhe të jashtëm gjatë gjithë procesit të formulimit dhe azhornimit të legjislacionit në fuqi,
- **Përforcimi i sundimit të ligjit:** PEK-u do të siguroi që nëpërmjet reformave në gjykata, prokurori dhe polici të mbrojnë paprekshmërinë e të drejtave mbi pasurinë publike dhe private,

duke i përmirësuar dhe përforcuar kontratat, si dhe duke hulumtuar mekanizmat tjerë të arbitrimin.

- **Institucionet publike:** PEK-u garanton përforcimin e kapaciteteve të institucioneve publike që të ballafaqohen me rritjen e kërkesave të një ekonomie në zgjerim e sipër, si dhe krijojnë shërbime civile të cilësisë së lartë që lehtësojnë bashkëveprimin e qeverisë me sektorin privat.
- **Politika e tatimit,** do të krijojë burime adekuate për mirëmbajtjen e shërbimeve civile, infrastrukturës fizike dhe institucionale, si dhe shërbimeve publike, pa u bërë barrierë e zhvillimit të sektorit privat. Sa i përket konkurrencës së tatimeve me vendet fqinje, do të hartojë politikën e tatimeve që i jep Kosovës një vend konkurrues në rajon.
- **Politika e shpenzimeve,** do të caktojë burime për aktivitetet që sjellin të ardhura më të mëdha. PEK-u përqendrohet tek burimet në fushat ku barrierat e transformimit janë më të larta (mungesa e promovimit të investimit, arsimimi i dobët, furnizimi joadekuat dhe me çmime të larta të energjisë elektrike).
- **Administrata dhe financat publike** – PEK-u do të sigurojë ndershmëri dhe efikasitet në procesin e financave publike.

### 3. SEKTORI PRIVAT DHE PROMOVIMI I INVESTIMIT

- **PEK-u** ka për qëllim të arrihet transformimi struktural i ekonomisë nga një ekonomi e bazuar në bujqësi në një ekonomi të bazuar në prodhim (përfshirë edhe atë industrial të lehtë dhe të rëndë) dhe shërbime, si dhe të zhvendosen aktivitetet nga fushat e produktivitetit të ulët në ato me produktivitet më të lartë.
- **Privatizimi,** Do të përdorim një proces të përforcuar dhe të përshpejtuar të privatizimit, për të përforcuar sektorët e energjisë dhe të minierave në veçanti, si dhe sektorët produktivë në përgjithësi. Do të përdorim privatizimin që t'i zhbllokojmë burimet dhe asetet, të cilat mund të përdoren më mirë në sektorin privat
- **Politika e tregtisë** – PEK – u do të hartojë në vazhdimësi një politikë tregtare, e cila, në një anë, nuk i dëmton konsumatorët, ndërsa, në anën tjetër, inkurajon zhvillimin e një sektori të shëndoshë privat në bazat e konkurrencës së ndershme. Do të përdorim politikën e tregtisë që të ofrojmë stimulime drejt daljes nga aktivitetet tradicionale dhe që të joshim FDI-në.

- **Sektori financiar** , Sektori financiar do të jetë gurthemeli i zhvillimit të sektorit privat. Do ta ruajmë nga rrezikimet tej mase dhe, në ndërkohë, promovojmë instrumente që të mundësojnë financimin e projekteve vitale që sjellin të ardhura të mëdha.
- **Promovimi i investimit** , PEK-u do të krijojë një sektor të shëndoshë privat me aktivitete të ndryshme që nxisin rritjen në një periudhë afatgjatë, duke promovuar investimin në sektorin privat në përgjithësi, si dhe duke vënë në prioritet investimin e aktiviteteve jotradicionale përmes stimulimeve të shënjuara me kujdes, si dhe përmes mbështetjes institucionale.
- **Politika e tatimeve** – PEK-u do të ofrojë stimulimet adekuate për zhvillimin e sektorit privat.

#### 4. ZHVILLIMI I BURIMEVE NJERËZORE

- PEK-u do të angazhohet në përmirësimin e bazës së burimeve njerëzore, që t'i përgjigjet kërkesave për shkathtësi në sektorin privat dhe atë publik.
- **Arsimimi** : do të përmirësojmë
  - (i) infrastrukturën e sistemit arsimor (numrin dhe kushtet fizike në çerdhe, kopështe dhe shkolla fëmijësh etj.); dhe
  - (ii) cilësinë e arsimit (tekstet, cilësinë e mësuesit, planprogramet, etj.). Do të kuptojmë perspektivat e rritjes dhe observojmë nga afër tregun e punës për sinjalet e kërkesës për shkathtësi dhe kualifikime të caktuara dhe të veprojmë shpejt që të stimulojmë furnizimin e tyre.
- **Politika sociale** : PEK-u do të ofrojë rrjete sigurie për mbështetjen e të pafavorshmëve në procesin e transformimit të ekonomisë, e cila do të shpjerë në dislokimin e fuqisë punëtore.

#### 5. BUJQËSIA

- PEK-u do të analizojë potencialin e fitimeve nga produktiviteti i sektorit të bujqësisë, duke i inkurajua bujqit që të përmirësojnë efikasitetin e praktikave të tyre aktuale, si dhe duke ndërmarrë ide të reja investuese. Do të përkrahim konsolidimin e tokës, duke përmirësuar efikasitetin e tregut të tokës përmes përforsimit të të drejtave mbi pasurinë dhe kontratave.
- Përkrahje të fermerëve

- Subvencione ne bujqesi

## **6. SHËNDETËSIA**

- PEK-u një prej prioriteteve kryesore do ta ketë shëndetin e qytetarit të Republikës së Kosovës i cili nuk do të ketë më nevojë për shërim jasht vendit
- Rritjen e buxhetit për shëndetësinë
- Investim në infrastrukturën shëndetsore
- Aplikimin e sigurimit shëndetësor
- Investim në kapitalin njerezor ( do te ketë financim për trajnime dhe shkollime për mjeket tanë)

## **7. TOLERANCA**

- PEK – u do të promovoj tolerancën ndaj bashkëqytetarëve pa dallim gjinie, feje dhe nacionaliti që jetojnë në Republikën e Kosovës.
- Do të ofrojmë shanse të barabarta për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës

## **8. AMBIENTI**

- PEK- u do të angazhohet për një ambient sa më ekologjik
- Për ruajtjen e ambientit dhe të natyrës duke forcuar ligjet dhe zbatimin e ligjeve në mbrojtjen e tyre.
- Benefite qeveritare dhe uljen e tatimeve për teknologjine e reja të cilat nuk bëjnë ndotjen e ambientit

## **9. KULTURA**

- PEK-u do të angazhohet për zhvillimin në kahjen pozitive të të gjitha fushave kulturore
- Investime në infrastrukturen sportive
- Përkrahje teatrove, kinemave dhe filmit dhe çfarëdo aktiviteti në fushën e artit dhe kulturës.